



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 642 / 5 prot.

Pogradec, më 15, 02, 2024

Lënda: Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

Z. MANJOLA KAMOLLI
KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar zonja Kryetare,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt vendimin, dhe relacionin shoqërues, për:

“PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SIPËRFAQES SË TOKËS PREJ 12,4682 HA, E NDODHUR NË NJËSITË ADMINISTRATIVE PROPTISHT, TREBINJE, BUÇIMAS QË MUND TË JEPEN ME QIRA.”

Me respekt,

KRYETARI

Ilir XHAKOLLI



Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: 1 (Një)

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: 2 (Dy)

Nr. i i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: 8(Tetë)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KESHILLI

Nr. ____ prot.

Pogradec, më ____ . ____ 2024

PROJEKT-VENDIM

Nr. ____, DATË ____ / ____ / 2024

PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SIPËRFAQES SË TOKËS PREJ 12,4682 HA, E NDODHUR NË NJËSITË ADMINISTRATIVE PROPTISHT, TREBINJE, BUÇIMAS QË MUND TË JEPEN ME QIRA.

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore" , neni 2 i ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", Udhëzimin nr. 1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" dhe Udhëzimit nr.2, datë 20.04.2016 "Për shfuqëzimin e udhëzimit nr. 3, datë 27.11.2013, të Këshillit të Ministrave "Për pezullimin e përkohshëm të udhëzimit nr.1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë ,

VENDOSI:

1.Të miratojë listën e sipërfaqes së tokës bujqësore prej 12.4682 Ha (Dymbëdhjete hekater dhe katermije e gjashtëqind e tetdhjete e dy metra),të ndodhur në Njësitë Administrative Proptisht, Trebinjë, Buçimas që mund të jepen me qera sipas listës.

Nr	Pronësia	Zona Kadastrale	Numëri Pasurisë	Vëndodhja Fshati	Lloji Pasurisë	Sipërfaqja në m2
1	Shtet	3280	35/1	Selcë e Poshtëme Proptisht	PF	40000
2	Shtet	3745	608/1	Vërdovë Buçimas	Arë	12700
3	Shtet	3036	160/1	Potkozhan Trebinjë	Pemtore	13000
4	Shtet	3036	530/1	Potkozhan Trebinjë	Arë	7900
5	Shtet	3472	49/12	Slabinjë Proptisht	Arë	20000
6	Shtet	2928	30	Peshkëpi Buçimas	Arë	3375
7	Shtet	2928	31	Peshkëpi Bucimas	Are	15525
8	Shtet	2928	84/23	Peshkepi Buçimas	Are	3770
9	Shtet	2928	127	Peshkepi Bucimas	Are	8412
				Totali		124682

2.Toka Bujqësore që do të jepet me qera do te shfrytëzohet vetëm për veprimtari bujqësore dhe te tjera veprimtari ne funksion te saj.

3.Afati i dhënies me qera do të jetë në përputhje me destinacionin e kultivimit por asnjëherë më i gjatë se afati i përcaktuar pikën IV të Udhëzimit nr. 1, datë:18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qera të tokave bujqësore të pandara".

4.Çmimi dysheme i vlerës së qerasë nuk do te jete jo më pak se 6000 (gjashtëmije) lekë Ha në vit sipas pikës nr 10 të Udhëzimit nr. 1, datë:18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qera të tokave bujqësore të pandara".

5.Per zbatimin e vendimit ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Çështjeve Juridike, si dhe Njësitë Administrative Proptisht, Trebinjë, Buçimas .

6.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

KRYETAR

MANJOLA KAMOLLI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

DREJTORIA E EMERGJENCAVE, STREHIMIT DHE ADMINISTRIMIT TOKES BUJQESORE NE NJESITE ADMINISTRATIVE
SEKTORI TRAJTIMIT TITUJVE PRONESISE DHE SHPRONESIMEVE

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më _____ . _____ .2024

Relacion

PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SIPËRFAQES SË TOKËS PREJ 12,4682 HA, E NDODHUR NË NJËSITË ADMINISTRATIVE PROPTISHT, TREBINJE, BUÇIMAS QË MUND TË JEPEN ME QIRA.

Të nderuar!

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore", neni 2 i ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", Udhëzimin nr. 1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" dhe Udhëzimit nr.2, datë 20.04.2016 "Për shfuqëzimin e udhëzimit nr. 3, datë 27.11.2013, të Këshillit të Ministrave "Për pezullimin e përkohshëm të udhëzimit nr.1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" dhe ne zbatim te urdherit nr 733 prot datë 21/09/2020 të Kryetarit të Bashkisë të vënë në zbatim me Memo me nr prot 3579 datë 03/08/2021, ligjit 57/220 "Per pyjet", VKM nr 559 date 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave per dhënie në përdorim të fondit pyjor kombëtar, per veprimtari ekonomike, si dhe per prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore" sektori i monitorimit te kontratave, kontrollit lejeve, shpronesimeve dhe qerave, ne bashkepunim me Njesite administrative ka evidentuar dhe listuar nje numër pasurish që mund të jepen me qera të sipërfaqes prej **12,4682 Ha** të ndodhur në Njësitë Administrative, Proptisht, Trebinje dhe Buçimas. Në referim të Udhëzimit nr. 1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qera të tokave bujqësore të pandara" dhe Udhëzimit nr.2, datë 20.04.2016 "Për shfuqëzimin e udhëzimit nr. 3, datë 27.11.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për pezullimin e përkohshëm të udhëzimit nr.1, datë 18.07.2012 , të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" , Bashkia Pogradec para se të kerkojë në Këshillin Bashkiak miratimin e listës ka kryer procedurat e mëposhtme ka marrë pranë Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, pranë Këshillit të Qarkut Korçë konfirmimin e faktin se keto sipërfaqe kane zërin kadastral tokë bujqësore dhe toke e pafrytshme, nga njesite administrative eshte sjelle konfirmimi, se nuk ka asnje nga keto pasuri qe preken nga persona private apo ka pretendime, gjithashtu prane Njesive administrative nuk eshte paraqitur asnje person pretendet apo pronar per keto pasuri kjo e konfirmuar nga shkresat e njesive administrative,

Gjithashtu theksojmë se asnjë nga këto pasuri **nuk është pjesë e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 995, datë 9.12.2015 Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të sipërfaqes së tokës bujqësore prej 926.55 ha, në pronësi shtetërore, dhënë në përdorim komunave Buçimas, Çërravë dhe Udenisht dhe për disa ndryshime në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 4.4.2012, nr. 417, datë 8.6.2011 dhe nr. 534, datë 1.5.2008.**

Gjithashtu këto parcela nuk janë pjesë e Vendimit Nr. 770, datë 12.11.2014 për kalimin në fondin e kompensimit fizik, në dispozicion të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, të sipërfaqes së tokës bujqësore prej 23 368.8 ha, në pronësi shtetërore, dhënë në përdorim të njësive të qeverisjes vendore, vendim që në Bashkinë Pogradec prek një sipërfaqe prej **1990,64 ha përkatesisht Njesia Administrative Velçan 391,35 Ha, Njesia Administrative Buçimas 238,11 Ha, Njesia Administrative Çërravë 50,09 Ha , Njesia Administrative Trebinjë 282,66 Ha, Njesia Administrative Dardhas 516,13 Ha, Njesia Administrative Proptisht 445,45 Ha dhe Njesia Administrative Udenisht 66,85Ha,**

Gjithashtu këto sipërfaqe toke i kanë kaluar në pronësi ose përdorim ish Komunave Proptisht, Buçimas dhe Trebinje sipas V.K.M-ve si më poshtë :

Vendimin nr. 605, datë 14.05.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së pronave të pronave pyje kullota, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës **Buçimas**, të qarkut të Korçës".

Vendimin nr. 278 , datë 18.03.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës **Trebinjë**, të qarkut të Korçës".

Vendimin nr. 1329 , datë 01.10.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës **Proptisht**, të qarkut të Korçës".

Gjithashtu theksojmë faktin se në zbatim të V.K.M-së nr. 510, datë 10.6.2015 " Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial" të gjitha të drejtat e pronësisë që iu takonin ish- Komunave tani i takojnë Bashkisë Pogradec.

Në këto kushte dhe bazuar në nënin 54 gërma "e" të ligjit 139/2015 "Per vetëqeverisjen vendore", nr. 531, datë 21.08.1998 "Për tokat bujqësore të pandara" i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qera të tokave bujqësore të pandara" dhe Udhëzimit nr.2, datë 20.04.2016 "Për shfuqëzimin e udhëzimit nr. 3, datë 27.11.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për pezullimin e përkohshëm të udhëzimit nr.1, datë 18.07.2012 , të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qera të tokave bujqësore të pandara" i propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë listën dhe sipërfaqet përkatëse të parcelave që mund të jepen me qera , të ndodhur në Njësitë Administrative Proptisht, Trebinje dhe Buçimas sipas tabelës dhe sasisë totale të pasqyruar në projektvendim

Në referim të bazës ligjore nga Drejtoria e emergjencave, strehimit dhe administrimit tokës bujqësore në njesite administrative, Sektori trajtimit titujve pronësisë dhe shpronësimeve, janë krijuar korrespondencat dhe dokumentacioni përkatës me Drejtorinë e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qark, Drejtorinë Rajonale të Bujqësisë, Angjesisë Shtetërore të Kadastres Drejtoria Vendore Pogradec dhe Njësitë Administrative për të zbatuar sa më mirë dhe Udhëzimin e Këshillit të Ministrave për dhënie me qera të këtyre sipërfaqeve dhe zbatimin edhe të urdherave që ka nxjerrë Kryetari i Bashkisë për zbatimin sa më të mirë dhe transparent të këtij Udhëzimi, duke përgatitur shkresat dhe modelet e akteve të verifikimit dhe njoftimet që njesite administrative kanë administruar dhe dhe marrë nga ana jone, një kopje të këtyre dokumentave po ja bashkangjimisht relacionit.

Theksojmë se Bashkia Pogradec do të beje aplikimet dhe pagesat përkatëse për paisjen me certifikata pronësie dhe deri në momentin që të dalin këto certifikata, nuk do vazhdojë procedura e dhënies me qera nga Bordi i Qeradhenies së Bashkisë Pogradec, dhe sektori përkatës.

Ju faleminderit!

Konceptoi: Gerond OSHAFI

Konfirmoi: Nexhmi TORRA

Miratoi Dritan BABASULI

**KRYETAR
ILIR XHAKOLLI**